

Nr 638 Inst dt. 10.06.05

Mirëlo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE DHE USHQIMIT
Drejtoria e Veterinarise

RREGULLORE

NR.....*1*.....DATE *25.5.2005*

MBI DISA NORMA TE TREGTIMIT TE VEZEVE

Ne mbeshtetje te nenit 119 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise,
te Ligjit Nr.9308 date 4.11.2004 "Per Sherbimin dhe Inspektoriatin
Veterinar",
te Direktives Nr.1907/90/BE e dates 26 qershor 1990 Mbi disa norma te
tregtimit te zbatueshme per vezet,
Ministri i Bujqesise dhe Ushqimit nxjerr kete Rregullore.

Neni 1

Kjo Rregullore percakton masat sanitaro-veterinare qe zbatohen ne pularite
qe ndodhen ne territorin e Republikes se Shqiperise per zbatimin e normave
te tregtimit te vezeve dhe te eksportimit te tyre ne vendet e antare te BE-se.

Neni 2

Per qellimet e kesaj Rregulloreje, termat e meposhtme kane kete kuptim:

1. veze-jane vezet e pulës me levozhge te konsumueshme ne kete gjendje ose
per perdorim nga industria ushqimore per prodhim ushqimesh per njerez
perjashto ketu vezet e thyera, vezet e inkubuara, dhe vezet e ferguara.

Ro asubur
10.0.05

2. veze industriale-jane veze pule me levzhge perveç atyre qe permenden ne piken 1 perfshire ketu vezet e thyera si dhe vezet e inkubuara por jo vezet e ferguara.

3. veze per inkubim-jane veze te destinuara per prodhim zogjsh ne perputhje me rregulloret e vezeve per kete qellim.

4. veze te thyera- jane veze me difekte ne levzhge dhe me membrana ku duket permbajtja nga poshte.

5. veze me zgaverr-jane veze me levzhge te zgavrruar nga brenda pa çarje te membranës.

6. veze te inkubuara- jane veze te futura ne incubator perfshire ketu edhe çastin e futjes per inkubim.

7. tregtim-mbajtje apo ekspozim vezesh per shitje, shitje e tyre apo çdo forme tjeter tregtimi.

8. mbledhes-çdo person i autorizuar nga autoriteti kompetent veterinar qe te mbledhe veze tek nje prodhues per ti derguar:

a. ne nje qender amballazhimi.

b. tek nje treg ku bleres jane grosistet ndermarrja e te cileve eshte miratuar si qender amballazhimi ose,

c. ne industri.

9. qender amballazhimi-ndermarrje e autorizuar nga autoriteti kompetent veterinar per te klasifikuar vezet sipas kategorise se cilesise dhe peshes.

10. sasi vezesh-teresia e vezeve qe vijne nga e njejta qender amaballazhimi e ndodhur ne te njejtin vend, me pigerina, me date te vendosur mbi amballazh ose me klasifikim ne te njejten kategori cilesie dhe peshe.

11. amballazhe te medha-jane amballazhe ose konteniere jo te mbyllur dhe qe permbajne mbi 36 veze.

12. amballazhe te vegjel-jane amballazhe te sheshta ose me fole(alveola) te rrethuar me plastike qe permbajne 36 veze ose me pak.

13. shitje rifuxhio-eshte shitje ne sasi te vogla vezesh jo te futura ne ambalazhe te vogla apo te medha.

Neni 3

Dispozitat per klasifikimin dhe shenimin e vezeve nuk zbatohen ne keto raste:

a. tek vezet e transportuara drejt per drejt nga vendi i prodhimit (nga pularia dhe kompania prodhuese) ne nje qender ambalazhimi ose ne nje treg ku blejne grosistet ndermarrja e te cileve eshte miratuar si qender ambalazhimi sipas Nenit 6 qofte edhe per qellime transformimi ne ndermarrje te industrise ushqimore te miratuara sipas Direktives 89/437/CEE te keshillit te dates 20 qershor 1989 per problemet higjienike dhe sanitare te prodhimeve te vezeve.

b. tek veze qe jane prodhuar dhe derguar per qellime transformimi tek ndermarrjet e industrise se prodhimit te ushqimeve per njerez te miratuara ne perputhje me Direktiven 89/437/CEE.

c. nuk i nenshtrohen dispozitave te kesaj Rregulloreje vezet e derguara nga prodhuesi drejt per drejt tek konsumatori per nevojat e tij personale, ne territorin ku ndodhet pularia, ne nje treg publik lokal me kusht qe vezet te origjinojne nga vete prodhuesi dhe qe nuk jane ambalazhuar sipas neneve 11, 12 dhe 13 dhe ku nuk perdoren treguesit e kategorizimit te cilesise dhe peshes parashikuar nga kjo Rregullore.

Neni 4

Vezet per te cilat behet fjale ne Nenin 2 pika 1 nuk duhet te perzihen me veze te prodhuara nga lloje te tjera shpendesh.

Neni 5

Prodhuesi duhet te nxjerre ne treg vetem:

a. veze per grumbulluesit, per qendrat e ambalazhimit, ne tregje per te cilat behet fjale ne Nenin 3, pika 2 ose per industri.

b. veze te inkubuara te destinuar per konfiskate perjashto industrine e prodhimit te ushqimeve per njerez.

c. vezet e thyera aksidentalisht ne qendrat e amballazhimit nuk mund te dergohen vetem se ne industri transformimi perjashto industrine e transformimit dhe industrine e prodhimit te ushqimeve per konsum human.

Neni 6

1. me perjashtim te rasteve te parashikuara nfa Neni 9, klasifikimi I vezeve sipas kategorise dhe peshes duhet te behet vetem ne qendrat e amballazhimit.

2. qendrat e amballazhimit te mbajne nje Liste me emrat e furnizuesve te tyre.

3. Autoriteti kompetent veterinar jep autorizim per klasifikimin e vezeve, i jep nr. dallues me kerkesen e tyre çdo ndermarrjeje ose çdo prodhuesi qe ka lokale si dhe paisje teknike te pershtatshme qe bejne te mundur klasifikimin e vezeve sipas cilesise dhe peshes. Autorizimi i mesiper mund te çfuqizohet atere kur nuk plotesohen kushtet e percaktuara.

Neni 7

Kategorite e cilesise se vezeve caktohen si me poshte:

Kategoria A (ose veze te fresketa).

Kategoria B (ose veze te cilesise se dyte apo te konservuara).

Kategoria C (ose veze te skualifikuara te destinuar per industrine e prodhimit te ushqimeve per konsum human).

Veze e kategorise A duhet te klasifikohen sipas peshes.

Neni 8

Vezet e kategorise A duhet te paisen me nje ose me shume shenja dalluese si me poshte:

a.me daten e amballazhimit ose ne rast se vezet shiten rifuxhio duhet te kene edhe daten e kategorizimit.

b.nje ose me teper data te tjera me qellim qe ti jipen konsumatorit te tjera te dhena plotesuese.

c.kategorine e cilesise.

d.kategorine e peshes.

e.numurin e qendres se amballazhimit.

f.emrin e qendres se amballazhimit.

g.shenjen e kompanise dhe shenjen e qendres se amballazhimit.

h.reference per menyren e mbareshtimit te shpendeve.

i.tregues per origjinen e vezeve.

j.kodin e identifikimit te kompanise.

Zbatimi I treguesve te pikave (f) dhe (g) I nenshtrohet edhe kushteve te parashikuara nga neni 11,paragrafi 1,pika a ndersa zbatimi I treguesve te pikave (b) , (h) dhe (i) I nenshtrohet respektimit te kushteve te parashikuara nga neni 11,paragrafi 3.

Neni 9

1.Vezet e kategorive B dhe C perjashto vezet e ambalazuara si kokerr,te paisen me nje shenim qe kapet me sy dhe qe tregon kategorine e cilesise. Keto veze mund te kene edhe tregues te tjere siç jane renditur ne nenin 8.

2. Vezet e kategorive A dhe B te cilat nuk plotesojne me karakteristikat e fiksuara per keto kategori, kualifikohen perseri respektivisht ne kategorite B ose C sipas karateristikave qe kane ne kete rast, keto veze duhet te paisen me nje shenim qe kapet me sy sipas pikes 1.
Shenjat e kategorizimit te cilesise dhe peshes mund te ndryshohen n. q. s. paraqitet rasti.

3. Pavarisist nga te dhenat e pikes 2, vezet e kategorive A dhe B qe nuk I pergjigjen me karakteristikave te ketyre kategorive mund te dergohen ne industrine e prodhimit te ushqimeve per konsum human pa shenjen e pikes 2 me kusht qe amballazhi I tyre te mbaje gjithmone nje etikete qe tregon qarte destinacionin e tyre.

Neni 10

Vezet nuk duhet te kene asnje shenje tjeter pervec atyre te percaktuara nga kjo Rregullore.

Neni 11

1. Amballazhet e medha dhe te vogla edhe athere kur keto te fundit futen tek amballazhet e medha, ne nje nga faqet e jashtme te tyre, me shkronja te qarta e te lexueshme te kene te shkruar:

a. emri, adresa ndermarrjes qe ka amballazhuar vezet;
emri, shenja tregtare te perdorura nga shume ndermarrje mund te vendosen perderisa jane ne perputhje me kete Rregullore ne lidhje me cilesine, freskine e vezeve, menyres se mbareshtimit te pershtatur per prodhimin si dhe origjinen e vezeve.

b. numurin e qendres se amballazhimit.

c. kategoria e cilesise dhe kategoria e peshes. Vezet e kategorise A mund te identifikohen me termat "Kategoria A" ose vetem me shkronje A shoqeruar ose jo me termin "te fresketa".

d. numurin e vezeve te amballazhuara.

e. daten e amballazhimit.

f.treguesin jo te koduar te kushteve te frigorifereve si dhe te metodes se konservimit kur behet fjale per veze te mbajtura ne frigorifer ose te konservuara.

2.Si amballazhet e medha ashtu dhe ato te vogla duhet te **kene** ne faqen e brendshme ose te jashtme te tyre te dhena te tjera si me poshte:

a.çmimin e shitjes.

b.kodin tregtar dhe kodin e kontrollit te magazinimit.

c.nje ose me shume te dhena te tjera per ti dhene konsumatorit me teper informacion.

d.tregues per te reklamuar shitjet ne masen kur keto tregues dhe menyra e vendosjes se tyre te mos informojne gabim bleresin.

3.te dhena e tjera si dhe te dhenat per menyren e mbareshtimit dhe origjines se vezeve duhet te perdoren vetem ne perputhje me rregullat e nenit 17 te Rregullores CEE Nr.2771/75.

Neni 12

1.Amballazhet e medha duhet te jene te pajisur me nje etikete me treguesit e permendur ne Nenin 11.Etiketa nuk eshte detyrueshme kur jane amballazhe te medha dhe konteniere te mbyllur me kusht qe keto konteniere te mos behen pengese per identifikimin e treguesve te nenit 11 qe figurojne ne amballazhet e vogla qe kane brenda.

2.Ne rast se ndermarrja amballazhimit dergon drejt per drejt per tregtim veze qe shiten rifuxhio dhe ne sasi te vogla keto veze mund te mos amballazhohen ne amballazhe te medha.

Neni 13

Fjala "extra" mund të përdoret mbi amballazhet e vogla që kanë brenda veze të kategorisë A pastruar me etikete. Kjo fjale duhet të shtypet mbi etikete e cila hiqet dhe eliminohet 7 ditë pas amballazhimit.

Neni 14

1. Vezet të cilat ekspozohen për shitje pjesë-pjesë duhet të mbahen të ndara nga njëra-tjetra sipas kategorisë së cilësisë, peshës, mbajtjes në frigorifer dhe mënyrës së konservimit.

Kategoria e cilësisë, peshës si dhe fakti që vezet kanë qene mbajtur në frigorifer apo konservuar, duhet të shënohen në mënyrë që të dallohen qartë nga konsumatori.

2. Kur vezet shiten rifuxhio, sipër tyre duhet të vendoset numuri i identifikimit të qendrës së amballazhimit që ka klasifikuar vezet dhe në rast se janë veze të importuara, të vendoset emri i vendit të origjinës si dhe data e kategorizimit të këtyre vezeve.

3. Pavarësisht nga kjo, vezet që bëjnë pjesë në të njëjtën kategori cilësie përjashtojnë ketu vezet e kategorisë A të tregtuara nën emërtimin "extra" sipas nenit 12 mund të ekspozohen për shitje të ambalazhuara dhe në sasi të vogla pavarësisht se janë kategorizuar në peshë të ndryshme me kusht që të tregohet peshë totale dhe të vendoset shënimi "veze të kalibrave të ndryshme" ose kategoritë e ndryshme të peshës.

Neni 15

Amballazhet nuk duhet të kenë asnjë tregues tjetër vetëm se ato të parashikuara nga kjo Rregullore.

Neni 19

1. Ne menyre qe te zbatohet kjo Rregullore, Autoriteti Kompetent Veterinar duhet te bazohet ne keto modalitete:

-frekuenca e mbledhjes , dergimit dhe trajtimit te vezeve.

-cilesia dhe kategorizimi i peshes se vezeve.

-treguesit mbi veze dhe mbi amballazhin e tyre.

2. Per percaktimin e kategorise se cilesise duhet te mbahen parasysh parametrat e meposhtem:

-pamja e guackes

-konsistenca e te bardhes se vezes

-lartesia e dhomes se ajrit

-pamja dhe pozicioni verdhes se vezes.

-mungesa e njollave dhe/ose trupave te huaj

-zhvillimi i njolles gjermnative.

Kjo Rregullore hyn ne fuqi menjehere

